

NISHOVA ENERGY shpk

Pasqyrat Financiare me 31 dhjetor 2014

Permbajtja:

	Faqe
Bilanci kontabel me 31 dhjetor 2014	2
Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen nga 1 Janar 2014 deri me 31 dhjetor 2014	4
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital per periudhen nga 1 Janar 2014 deri me 31 dhjetor 2014	5
Pasqyra e flukseve monetare per periudhen nga 1 Janar 2014 deri me 31 dhjetor 2014	6
Shenime shpjeguese te pasqyrave financiare	7-18

NISHOVA ENERGY shpk

Bilanci kontabel

me 31 dhjetor 2014

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)


<u>Aktivitet</u>	Shenime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
I. Aktivet afatshkurtra			
Mjete monetare	4	14,770,712	5,380,038
TVSH e arketueshme	5	21,099,719	14,331,938
Shpenzime te periudhave te ardhme	5	16,265,833	11,031,819
Parapagime	5	6,353,840	49,462,560
Inventare	6	796,931	14,710,340
Total i aktiveve afatshkurtra (I)		59,287,035	94,916,694
II. Aktivet afatgjata			
Koncesione dhe të drejta të ngjashme, liçensa të ngjashme	7	72,637,788	72,637,788
Aktive ne proces	7	97,424,646	
Mjete transporti	7	2,933,312	
Totali i aktiveve afatgjata (II)		172,995,745	72,637,788
Totali i aktiveve (I + II)		232,282,781	167,554,482
<u>Detyrimet dhe kapitali</u>			
I. Detyrimet afatshkurtra			
Llogari te pagueshme	8	6,701,207	6,875,853
Te pagueshme ndaj personelit	9	1,560,092	1,156,896
Detyrime tatimore	10	42,478	8,370
Detyrime te tjera	10	59,538	4,916,749
Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		8,363,316	12,957,868
II. Detyrimet afatgjata			
Totali i detyrimeve afatgjata (II)		227,038,400	154,220,000
Detyrime ndaj ortakeve	11	227,038,400	154,220,000
Te ardhura te periudhave te ardhme		-	-
Totali i detyrimeve (I + II)		235,401,716	167,177,868
III. Kapitali			
Kapitali i shoqerise	12	4,679,086	4,679,086
Rezultati i ushtrimit	12	(4,302,407)	(2,579,086)
Fitimi i periudhes	12	(3,495,614)	(1,723,386)
Totali i kapitalit (III)		(3,118,935)	376,614
Totali i detyrimeve dhe kapitalit (I,II,III)		232,282,781	167,554,482

Pasqyrat financiare u aprovuan nga Nishova Energy shpk dhe u nenshkruan si me poshte:

Sign and Stamp here

z. Isidoro Rebatto

Perfaqesues ligjor



Bilanci kontabel duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 - 19 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

NISHOVA ENERGY shpk
Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve
 per periudhen nga 1 janar 2014 deri me 31 dhjetor 2014

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

	Shenime	Per periudhen nga 1 Janar 2014 deri me 31 Dhjetor 2014	Per periudhen nga 1 Janar 2013 deri me 31 Dhjetor 2013
Te ardhurat nga aktiviteti			
Te ardhura nga prodhimi i aktiveve	13	20,895,878	37,748,714
Te ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata		0	0
Te ardhura te tjera		0	0
		20,895,878	37,748,714
Shpenzimet operative			
Materiale te konsumuara	14	(20,895,878)	(18,862,107)
Shpenzime personeli			
-pagat e personelit	15	(724,120)	(544,425)
-kontributet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	15	(134,599)	(90,918)
Amortizimi dhe zhvleresimi		0	0
Shpenzime te tjera	16	(2,492,594)	(20,178,339)
		(24,247,191)	(39,675,789)
Fitimi nga veprimtaria kryesore		(3,351,313)	(1,927,075)
Te ardhura/shpenzime nga interesa		0	171,867
Te ardhura/shpenzime nga kursi kembimi	17	(144,301)	28,328
Totali i te ardhurave financiare - neto		(144,301)	200,195
Fitimi para tatimit		(3,495,614)	(1,726,880)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	18	0	0
Fitimi i periudhes		(3,495,614)	(1,726,880)

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 - 18 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

NISHOVA ENERGY shpk

Pasqyra e ndryshimit ne kapitaleve

per periudhen nga 1 janar 2014-deri me 31 dhjetor 2014

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

	Kapitali	Rezerva nga konvertimi i monedhave te huaja	Fitime te akumuluar	Totali
Pozicioni me 01 Janar 2013	4,679,086	-	(2,579,086)	2,100,000
Dividente te paguar			-	-
Fitimi neto i periudhes			(1,726,880)	(1,726,880)
Me 31 dhjetor 2013	4,679,086	-	(4,305,966)	373,120
	Kapitali	Rezerva nga konvertimi i monedhave te huaja	Fitime te akumuluar	Totali
Pozicioni me 01 Janar 2014	4,679,086	-	(4,302,407)	376,679
Dividente te paguar			-	-
Humbja neto i periudhes			(3,495,614)	(3,495,614)
Me 31 dhjetor 2014	4,679,086	-	(7,798,021)	(3,118,935)

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 – 18 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

NISHOVA ENERGY shpk**Pasqyra e fluksve te parase**

per periudhen nga 1 janar 2014 deri me 31 dhjetor 2014

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
I. Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit		
Fitimi i periudhes	(3,495,614)	(1,726,880)
Rregullime per:		
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-	-
Amortizimi	-	-
Provizione		
Fitimi nga kembimi te perealizuara	-	-
Humbje nga kembimi te perealizuara	-	-
Te ardhura /Shpenzime per interesa		
Fitimi operativ para ndryshimeve ne kapitalin punues	(3,495,614)	(1,726,880)
Rritje ne llogarite e arketueshme		
Rritje ne llogarite te tjera te arketueshme	31,106,924	(67,769,432)
Rritje ne llogarite e inventarit	13,913,409	(14,710,340)
Rritje ne llogari te pagueshme	(4,590,994)	(1,508,898)
Rritje ne detyrime te tjera		0
Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit	-	-
Fluksi neto monetar perdorur ne veprimtarite e shfrytezimit	36,933,725	(85,715,550)
II. Fluksi monetar nga veprimtarite e investimit		
Blerje aktiveve afatgjata	(100,357,958)	(59,281,248)
Fluksi neto monetar perdorur ne veprimtarite e investimit	(100,357,958)	(59,281,248)
III. Fluksi monetar nga veprimtarite e financimit		
Kapital i derdhur	-	-
Financime	72,818,400	4,579,086
Fluksi neto monetar nga veprimtarite e financimit	72,818,400	144,509,600
IV. Rritja/(pakesimi) neto i mjeteve monetare	9,394,168	4,091,889
V. Mjetet monetare ne fillim te periudhes	4 5,376,545	1,284,656
VI. Mjetet monetare ne fund te periudhes	4 14,770,712	5,376,545

Pasqyra e flukseve monetare duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 – 18qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

NISHOVA ENERGY shpk

Shenime

per periudhen nga 1 janar 2014 deri me 31 dhjetor 2014

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

1. Informacion i pergjithshem

Nishova Energy shpk (ne vijim referuar si “shoqeria”) eshte e regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me Nentor 2011 si shoqeri me pergjegjesi te kufizuara. Shoqeria eshte e regjistruar me Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane. NIPT/NUIS K99631401M.

Objekti i shoqerise eshte ndertimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve Nishova 1 dhe Nishova 2 tek Autoriteti Kontraktues, ku perfshihet financimi, ndertimi, venia ne pune, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shperndarja, eksportimi dhe shitja e energjise elektrike, ne zbatim te Kontrates se Koncesionit me Ministrine e Ekonomise, Tregtise dhe Energjistikes.

Ortaket e shoqerise paraqiten si me poshte vijon:

Fidalco zoteron 50% te kuotave;
Geo Energy zoteron 50% te kuotave ;

Perfaqesuesi ligjor i shoqerise eshte z. *Isidoro Rebato*.

Adresa e Shoqerise eshte Tirane Rruga Bardhok Biba, Pallati Trema Kati IV.

Numri i punonjesve te Shoqerise me 31 dhjetor 2014 eshte 1.

2 Bazat e pergatitjes se pasqyrave financiare

2.1 Bazat e pergatitjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) ne Shqiperi.

Drejtimi i shoqerise vlereson qe shoqeria do te vijojte aktivitetin normal tregetar per 12 muajt qe pasojne muajin e mbylljes se ketyre pasqyrave financiare. Per rrjedhoje, sipas parashikimeve te Ligjit Nr. 9228, date 29 prill 2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, pasqyrat financiare per vitin ushtrimor 2014 jane pergatitur ne baze te parimit te vijimesise.

Bazuar ne SKK 11 “Tatimi mbi te Ardhurat”, paragrafi 4, shoqeria ka vendosur te mos njohe tatimet e shtyra ne pasqyrat e saj financiare.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Lek, qe eshte dhe monedha funksionale e Shoqerise.

2.4 Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te kompanise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varesi te ketyre vleresimeve.

NISHOVA ENERGY shpk

Shenime

per periudhen nga 1 janar 2014 deri me 31 dhjetor 2014

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel jane te njohura ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar si dhe ne periudhat e ardhshme qe preken nga rivleresimi.

Ne veçanti, informacionet mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve dhe gjykimeve ne aplikimin e politikave kontabel te cilat kane efektet me te rendesishme ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare, jane pershkruar ne shenimet perkatese te pasqyrave financiare. Perdorimi i vleresimeve kontabel eshte minimal ne keto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtesine e veprimeve te realizuara nga shoqeria.

3. Politikat kontabel

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente ne periudhen qe fillon me 01 janar 2014 deri me 31 dhjetor 2014.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit.

Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehin ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlere e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Kursi kembimi me date 31.12.2014 eshte 140.14 leke/euro.

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare jo-derivative perbehen nga llogari te arketueshme, mjete monetare, hua te marra dhe te dhena, dhe llogari te pagueshme.

Instrumentat financiare jo-derivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to, perveç siç pershkruhet me poshte. Per instrumentat e mbajtur me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Ne vijim te njohjes fillestare instrumentat financiare jo-derivative maten siç pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te Shoqerise mbi flukset e parase se aktivitet financiar ose kur shoqeria transferon aktivitet financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe perfitimet thelbësore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te Shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat. Per qellimin e pasqyres se flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet te

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

saj perfshijne depozita pa afat me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

Llogari te arketueshme

Llogarite e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provizioni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose vonesa ne pagesa konsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provizionit llogaritet si difference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Hua te marra dhe te dhena

Huate e marra dhe te dhena njihen fillimisht me vleren e tregut, pa perfshire koston e transakcioneve. Pas njohjes fillestare, huate e marra dhe te dhena paraqiten me kosto te amortizuar duke njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve çdo difference midis koston dhe vleres se pagueshme nominale pergjate periudhes se huamarrjes duke u bazuar ne interesin efektiv.

Te tjera

Instrumenta te tjere jo-derivative maten me kosto te amortizuar sipas metodes se interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvleresimi.

3.3 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve te vete-ndertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, çdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivitetit ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes ne gjendjen e meparshme te vendndodhjes se aktivitetit. Shpenzimet kapitale te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Ndertime ne proces" dhe transferohen ne kategorine perkatese te aktivitetit kur perfundon ndertimi tij, nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorise.

Ne rastet kur pjese te nje aktiviteti afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur, dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave.

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

(ii) Kostot e mepasshme

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale llogaritet mbi jeten e vleresuar te cdo pjese te aktiviteti duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke perdorur metoden lineare te amortizimit mbi jeten e vleresuar te cdo pjese te aktivitetit afatgjate material dhe duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne cdo date raportimi.

3.4 Zhvleresimi

(i) Aktivitetet financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet i zhvleresuar nese ka te dhena objektive qe tregojne se nje apo disa ngjarje kane efekte negative ne flukset e ardhshme qe parashikohet te burojne nga aktiviteti.

Nje zhvleresim ne lidhje me aktivitetin financiar, te matur me kosto te amortizuar, llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktivitetet financiare te rendesishme individualisht testohen per zhvleresim ne menyre individuale. Aktivitetet e tjera financiare vleresohen ne menyre te grupuar, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut kreditor.

Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Cdo shpenzim i akumuluar i lidhur me nje aktiv financiar i disponueshem per shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Nje humbje nga zhvleresimi rimerret nese rimarrja mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes se humbjes nga zhvleresimi. Per aktivitetet financiare te matura me kosto te amortizuar, rimarrja njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

3.4 Zhvleresimi (vazhdim)

(ii) Aktivitetet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare te Shoqerise rishikohet ne cdo date raportimi per te percaktuar nese ka te dhena per zhvleresim. Nese ka te dhena te tilla atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Nje humbje nga zhvleresimi njihet nese vlera e mbetur e nje aktiviteti tejkalon vleren e tij te rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

NISHOVA ENERGY shpk

Shenime

per periudhen nga 1 janar 2014 deri me 31 dhjetor 2014

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

3.5 Provizionet

Nje provizion njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar, shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkoje flukse dalese parash per shlyerjen e tij. Provizionet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme skontimi para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimin ne fjale.

3.6 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat nga sherbimet e ofruara njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne varesi te fazes se perfundimit te transaksionit ne daten e bilancit. Asnje e ardhur nuk njihet nese ka pasiguri te larte lidhur me kryerjen e pageses dhe kostove perkatese.

3.7 Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin e periudhes, i cili njihet drejtperdrejt ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhes eshte tatimi i pritshem per t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme te vitit, duke perdorur normat tatimore te miratuara ne periudhen e raportimit.

4. Mjete Monetare

Mjete monetare me 31 dhjetor 2014 jane perbere si me poshte:

<i>Mjete monetare</i>	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Veneto Bank ne leke	(16,269)	(1,922)
Raiffeisen ne leke	-	10,086
Veneto Bank ne euro	14,786,981	5,371,874
Vlera monetare, në lekë	0	-
Shuma	14,770,712	5,380,038

NISHOVA ENERGY shpk

Shenime

per periudhen nga 1 janar 2014 deri me 31 dhjetor 2014

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

5. Llogari te arketueshme

Llogari te arketueshme me 31 dhjetor 2014 jane perbere si me poshte:

Llogari te tjera te arketueshme

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
TVSH e arketueshme	21,099,719	14,331,938
Shpenzime te periudhave te ardhme	16,265,833	11,031,819
Parapagime	6,353,840	49,462,560
Shuma	43,719,392	74,826,316

6. Inventare

Inventare me 31 dhjetor 2014 jane perbere si me poshte:

Inventare

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Inventare	796,931	14,710,340
Shuma	796,931	14,710,340

7. Aktive afatgjata

Llogarite aktive afatgjata me 31 dhjetor 2014 jane perbere si me poshte:

Aktive afatgjate

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Koncesione dhe të drejta të ngjashme, liçensa të ngjashme	72,637,788	72,637,788
Aktive ne proces	97,424,646	
Mjete transporti	2,933,312	
Shuma	172,995,745	72,637,788

NISHOVA ENERGY shpk

Shenime

per periudhen nga 1 janar 2014 deri me 31 dhjetor 2014

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

8. Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme me 31 dhjetor 2014 jane perbere si me poshte:

<i>Llogari te pagueshme</i>	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Ilda Duhaxhiu		353,304
Armandi shpk	6,761,131	6,522,549
Shuma	6,761,131	6,875,853

9. Detyrime personeli

Detyrimet e personeli me 31 dhjetor 2014 jane perbere si me poshte:

<i>Te pagueshme ndaj personelit</i>	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Paga dhe shperblime	1,560,092	1,156,896
Shuma	1,560,092	1,156,896

10. Detyrime tatimore

Detyrime tatimore me 31 dhjetor 2014 eshte perbere si me poshte:

<i>Detyrime tatimore</i>	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Sigurime Shoqerore dhe Shendetesore	39,618	8,370
Tatim mbi te ardhurat personale	2,860	-
Detyrime te tjera	59,538	-
Shuma	102,016	8,370

NISHOVA ENERGY shpk

Shenime

per periudhen nga 1 janar 2014 deri me 31 dhjetor 2014

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

11. Te drejta e detyrime ndaj ortakeve

Te drejta e detyrime ndaj ortakeve me 31 dhjetor 2014 eshte perbere si me poshte:

Te drejtu /detyrime ndaj ortakeve

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Geo Energy srl	117,726,750	77,110,000
Fidalco spa	109,311,650	77,110,000
Shuma	227,038,400	154,220,000

12. Kapitali i vet

Kapitali i vet me 31 dhjetor 2014 eshte perbere si me poshte:

Kapitali i vet

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kapitali i shoqerise	4,679,086	4,679,086
Humbje te mbartura	(4,302,407)	(2,579,086)
Fitimi(Humbje) i periudhes	(3,495,614)	(1,723,386)
Shuma	(3,118,935)	376,614

13. Te ardhura nga prodhimi i aktiveve

Te ardhura nga prodhimi i aktiveve gjate vitit 2014 rezultojne si me poshte:

Te ardhura nga prodhimi i aktiveve

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Te ardhura nga prodhimi i aktiveve	20,895,878	37,748,714
Shuma	20,895,878	37,748,714

14. Materiale te konsumuara

Shpenzimet per materiale te konsumuara gjate vitit 2014 jane perbere si me poshte:

Materiale te konsumuara

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Blerje mallra	(20,895,878)	(18,862,107)
Shuma	(20,895,878)	(18,862,107)

NISHOVA ENERGY shpk

Shenime

per periudhen nga 1 janar 2014 deri me 31 dhjetor 2014

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

15. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit jane perbere si me poshte:

Shpenzime personeli

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Paga	(724,120)	(544,425)
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	(134,599)	(90,918)
Shuma	(858,719)	(635,343)

16. Shpenzime te tjera.

Shpenzimet te tjera jane perbere si me poshte:

Shpenzime te tjera

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Blerje /Shpenzime të tjera	(36,026)	(1,180)
Trajtime të përgjithshme	-	(18,896,145)
Sherbime konsulence	(645,770)	(768,403)
Shpenzime për shërbimet bankare	(125,761)	(389,556)
Taksa, tarifa doganore	(7,200)	(9,481)
Tatime të tjera	(85,120)	(113,573)
Sherbime noterie	-	
Sigurime	(1,569,398)	
Transferime, udhëtime, dieta	(16,819)	
Shpenzime kancelarie	(6,500)	
Shuma	(2,492,594)	(20,178,339)

17. Te ardhura financiare - neto

Te ardhurat financiare – neto jane perbere si me poshte:

Te ardhura/humbje nga kembimi

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Fitime nga shkembimet valutore	296,768	330,632
	296,768	330,632

NISHOVA ENERGY shpk

Shenime

per periudhen nga 1 janar 2014 deri me 31 dhjetor 2014

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

18. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqeria per periudhen 31.12.2014 rezulton me nje humbje fiskale prej 6,765,141 leke.

Fitimi kontabel (humbja)	(3,495,614)
Shpenzime te panjohura sipas ligjit fiskal	
Blerje /Shpenzime të tjera	-
Shpenzime kancelarie	-
Trajtime të përgjithshme	-
Të tjera	-
Transferime, udhëtime, dieta	-
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	-
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	-
Totali i shpenzimeve te panjohura	-
Totali i rregullimeve nga kontabiliteti te fitimi(humbja) fiskale	(3,495,614)
Humbja fiskale e mbartur nga 2013	(1,726,880)
Humbja fiskale e mbartuar 2012	(1,542,647)
Humbja fiskale per tu mbartur ne vitin 2015	(6,765,141)

Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit por te ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar per qellime tatimi konsiderohen vetedeklarime deri ne momentin qe autoritetet tatimore shqyrtojne deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe leshojne vleresimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare jane objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

19. Angazhime dhe pasiguri

Gjate aktivitetit normal te biznesit, shoqeria mund te perfshihet ne pretendime te ndryshme nga te trete dhe masa ligjore. Vecanerisht, legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili hyri ne fuqi ose qe konsiderohet si i hyre ne fuqi ne fund te periudhes raportuese, eshte objekt i interpretimeve te ndryshme per sa i perket zbatimit te tij per transaksionet dhe aktivitetet e Shoqerise. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor ndermarre nga drejtimi dhe dokumentacioni zyrtar i cili mbeshtet qendrimet tatimore mund te kundërshtohet me sukses nga autoritetet perkatese. Periudhat fiskale mbeten te hapura per shqyrtim nga autoritetet per pese vite kalendarike para vitit te shqyrtimit. Nen rrethana te caktuara shqyrtimet mund te mbulojne periudha me te gjata.

Me 31 dhjetor 2014, shoqeria nuk ka angazhime kapitale apo operacionale te kontraktuara por ende te paguara.

19. Ngjarje te mepasshme

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.